# DËSHMI ARKIVI

**A-470627**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Fitoi jackpot 223 milionë euro, ish-gruaja i bëhet ‘makth’/Ja se çfarë i kërkon! \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/fitoi-jackpot-223-milione-euro-ish-gruaja-i-behet-makth-ja-se-cfare-i-kerkon/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 06:45:19 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 06:14:52 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a3d1d94b2043e366a5d183aa44b74572d27c70e163fe6299e6b9f73338a706ce` |
| TEKSTI | `6ff3c7e018613ec818b1a2240558777a91c5f693bc8e615175a68e7e1fc49afd` |
| PAMJA | `6338f8ae5e0c69f7eaa744aa2e99931e6541144f7ab241585282c0a5385e8515` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4754c772574e7734322b8e870654493064505e8abb7fe06ca4e17abe83543652` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4754c772574e7734322b8e870654493064505e8abb7fe06ca4e17abe83543652`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Bota

# Fitoi jackpot 223 milionë euro, ish-gruaja i bëhet 'makth'/Ja se çfarë i kërkon!



*Marisa Karabeci*

*26 Shtator 2026*




Një jackpot prej 223.2 milionë eurosh ka kthyer në një betejë ligjore fatin e një bankieri nga Oggiono, në provincën e Lecco-s, në Itali. Burri fitoi shumën marramendëse me një biletë vetëm 5 euro, por tashmë përballë tij është gruaja nga e cila është divorcuar më herët, e cila kërkon një pjesë të konsiderueshme të parave.

Sipas raportimeve të Corriere della Sera, gruaja pretendon se ka të drejtë mbi 50% të fitimit, pasi pavarësisht ndarjes faktike, çifti nuk e ka formalizuar ligjërisht divorcin. Historia nisi më 11 shtator, kur bileta e blerë në Oggiono që kushtoi vetëm 5 euro rezultoi fituese e jackpotit prej 223.2 milionë eurosh. Fituesi, i cili punon si bankier, thuhet se ua kishte treguar lajmin disa miqve të tij. Informacioni më pas u përhap dhe mbërriti edhe te bashkëshortja e tij, e cila jeton me prindërit në Frosinone, më shumë se 600 kilometra larg.

Avokatët e gruas argumentojnë se ajo ka të drejtë mbi gjysmën e shumës, pasi regjimi ligjor i pasurisë së përbashkët mes bashkëshortëve vazhdon të jetë në fuqi. Çifti është ndarë faktikisht, por nuk e ka përfunduar procedurën ligjore të ndarjes dhe sipas avokatëve, kjo do të thotë se fitimi mund të konsiderohet pjesë e pasurisë së përbashkët. "Gjysma e këtyre parave është e imja", pretendon gruaja, e cila përmes avokatëve ka kërkuar një marrëveshje me ish-bashkëshortin.

Ajo ka propozuar që ndarja të formalizohet përmes negociatave të asistuara, duke kërkuar një pagesë mujore prej 8 mijë eurosh, ose një pagesë të menjëhershme prej 80 milionë eurosh. Sipas përfaqësuesve të saj ligjorë, kjo shumë do të ishte më e ulët se gjysma e fitimit neto të burrit, e cila vlerësohet në rreth 179 milionë euro. Ndërkohë, protagonisti kryesor i historisë nuk është shfaqur publikisht dhe ende nuk ka marrë paratë e fituara.

Avokatët e gruas besojnë se ai mund ta kundërshtojë pretendimin, duke u mbështetur te fakti se çifti është i ndarë prej kohësh. Megjithatë, sipas tyre, jurisprudenca italiane ka përcaktuar se fitimet

nga lotaritë dhe lojërat kombëtare mund të përfshihen në regjimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, edhe në rastet kur bileta është blerë me paratë personale të vetëm njërit prej tyre. Në këtë rast, çështja pritet të varet nga statusi juridik i martesës dhe momenti kur ndarja ligjore konsiderohet e përfunduar. Deri atëherë, 223.2 milionë eurot mbeten në pritje, ndërsa fituesi duhet të përballet jo vetëm me fatin e jashtëzakonshëm të lotarisë, por edhe me një betejë të mundshme ligjore për pasurinë.

## LAJME TË NGJASHME



Përdorte fëmijë duke i dhunuar për të vjedhur turistët në Paris, e pëson keq 48-vjeçari!

1 MIN



Eksperiment i pazakontë, lëshohen 30 mijë mushkonja sterile që nuk pickojnë!

2.5 MIN



Skandal më fondet e investimeve në Turqi, autoritetet marrin nën hetim 76 persona, arrestohen 45 prej tyre!

1 MIN



Itali/ Kufizimi i nxënësve të huaj në klasa, kryebashkiakja e Pieve di Cadore: Erdha nga Shqipëria kur isha në klasë të katërt, vitin tjetër ndihmoja shokët!

4 MIN




“Ky vend e tradhtoi Hashim Thaçin”, Rama nga SHBA: Nuk u bë më e mira për George Washington-in e Kosovës

1.5 MIN

## MË TË LEXUARAT



“Një politikan, vajza e Alfred Cakos dhe…”/ Bledi Mane zbulon banorët e këtij sezoni të BBV?



E reja vjen me një njoftim interesant: “Kërkoj një burrë me mbiemrin tim…”



Nations League, Kosova debuton me fitore!



Italia ndalon burkën në shkolla/Kufizime edhe për nxënësit e huaj në klasa!



Parada Seksi e Yjeve: kush do të digjet nga dashuria këtë fundjavë!



Si i jep fund marrëdhënieve secila shenjë e zodiakut!



55-vjeçarit i nxjerrin nga barku ngjalën e gjallë pas një dite!



Në këtë vend mendojeni dy herë para se të dëgjoni muzikë me zë të lartë, do të gjobiteni!



Agim Ademi, mesazh emocionues pas fitores së “Dardanëve”!



Rama në Këshillin Europian të Korporatave: Paqja, kusht për zhvillimin ekonomik!

## EDITORI SUGJERON



Sa kalori digjen gjatë vërtetë seksit?!



"Zemra ndalet për gjysmë ore…"/ Prof. Dr. Altin Veshti zbulon çfarë ndodh gjatë operacionit: Pacientët kanë frikë!



Melatonina apo L-Theanine?! Ja cili suplement mund të ndihmojë më shumë me gjumin...



Të njëjtat vargje të përsëriten gjithë ditën? Ja pse një këngë mund të të "ngecë" në kokë...



Një ilaç i ri për kancerin e pankreasit mund t'u japë pacientëve më shumë kohë!



"Një politikan, vajza e Alfred Cakos dhe…"/ Bledi Mane zbulon banorët e këtij sezoni të BBV?



A vazhdon të jetë i virgjër? At Nikolla Xhufka tregon si vepron kur përballet me tundimet seksuale: Edhe tani me vajza të bukura…



"Më bezdis përndjekja..."/Ina Aderi: Më kanë ngacmuar personazhe, do dashurohem larg kamerave...



Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb!



Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie...

**RRETH NESH**

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

**KONTAKT**

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:
[email protected]

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

**COPYRIGHTS**

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

**LINKS**

- Kontaktoni
- Marketing
- Frekuencat
- Aksesueshmëria
- Mundësi Punësimi
- Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.